



13-25-2020
REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 28.02.2020

PROCESVERBAL

i mbledhjes së XII-të (e dymbëdhjetë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbledhjes së -II- të jashtëzakonshme të datës:27.09.2019 -II- urgjente datë:27.11.2019 .
2. Shqyrtimi i Raportit nr. 02/470 datë:19.08.2019 të Komisionit për shqyrtimin e raportit të Kompanisë "Ekoregjioni", Njësia në Malishevë për vitin 2018.
3. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Urbanizëm, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2019.
4. Paraqitja e listës së përfituesve me farëra dhe plehra për mbjelljet vjeshtore për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i dhe miratimi i kërkesës nr.02/654 datë:27.11.2019 për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2020.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Shtabit Koordinues të ndihmave për zonat e prekura nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë.
8. Shqyrtimi i Peticionit nr.02/705 datë:18.12.2019 të parashtruar nga banoret e fshatit Bellanicë.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2020.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për Transparencë në Komunën e Malishevës, sipas kërkesës nr.02/691 datë:17.12.2019.
11. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/681 datë:13.12.2019 të parashtruar nga kryesuesja e Komitetit për Barazi Gjinore.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1403 datë:22.11.2019 të parashtruar nga kryetari i fshatit Astrazup për dhënie të shfrytëzimit të pronës shoqërore për ndërtimin e Odës (objektit) të Komunitetit të lagjes.
13. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 27.12.2019 dhe filloi në ora 10:35 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 11 asambleistë, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, KFORI dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! Sipas planfikimit është dashur të fillojë mbledhja sepse ora është bërë 10:03. Tani të pranishëm janë 11 asambleistë si dhe me Alban Krasniqin që është diku këndeje para jemi 12. Kourrum nuk kemi. Kërkoj mendimin e shefave të grupeve politike sepse mbledhja pa kourrum nuk mund të vazhdojë. A do ta shtyejmë këtë mbledhje apo jo?

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kjo është një përgjegjësi e atyre që mungojnë e sidomos të përfaqësuesëve të NISMA sepse as në mbledhjen e kaluar nuk ishin të pranishëm në mbledhje. Në mungesë të kourrumit kjo mbledhje të shtyhet për një ditë tjetër.

Rrahim Morina: Kjo sjellje është e pahijshme nga Qeveria Komunale dhe nga NISMA që sot nuk janë këtu. E kanë obligim që të jenë këtu sepse janë votuar nga qytetarët sepse i kemi disa pika të rëndësishme këtu.

Kjo mbledhje shtyhet për një kohë të pacaktuar dhe me kohë do t'ju informojmë.

Mbledhja përfundoi në ora 10:08.

*

*

*

Vazhdimi i mbledhjes së XII (dymbëdhjetë) të rregulltë të Kuvendit të Komunës

Mbledhja mbahet me datë 30.12.2019 dhe filloi në ora 10:35 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 13 asambleistë, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë! Po e hapi mbledhjen e 12-të rregulltë por kourrum nuk kemi sepse jemi vetë 13 asambleistë në sallë. Informacion kam vetë për Leonitën e cila ka kërkuar leje për këtë mbledhje dhe për të tjerët nuk kam asnjë informacion. Kjo nuk është një

papërgjegjësi e anëtarëve të Kuvendit. Kourrum nuk kemi dhe nuk e di si ta vazhdojmë këtë mbledhje.

I përshendes qytetarët e fshatit Bllanicë që kanë ardh për çështjen e gurthyesit.

Alban Krasniqi: Atë ditë mbledhja u mbyll shpejt pa e hapur fare dhe ne u dakorduam që të mbahet sot. PDK-ja mungon për motive që ata i dinë dhe kërkoj na kolegët e NISMA që ta bëjnë kourrumin. Nëse vazhdon kështu të funksionojë komuna dhe Asambleja është mirë që shkojmë në zgjedhje se kështu nuk bënë më. Ky Kuvend është i thirrur për t'i mbrojtur interesat e përgjithshme jo individuale dhe një grupi të njerëzve të ngushtë të biznesit.

Rrahim Morina: Kërkesë e disa të anëtarëve të këtij Kuvendi dhe të qytetarëve të Bellanicës ishte që kjo seancë të mbahet para Vitit të Ri dhe kjo është një papërgjegjësi totale e anëtarëve të këtij Kuvendi. Mund t'i presim edhe 30 min e më pas mund ta shtyejmë përsëri këtë mbledhje.

Behije Sertolli: Pershendetje për të pranishmit dhe ju bashkëqytetarë të Bellanicës! Sot do të duhej të ishin të pranishëm të gjithë asambleistët sepse shqetësimin që kanë të gjithë qytetarët e Bellanicës është shqetësim i të gjithëve dhe që dëmton edhe fshatra të tjerë. Ne në Bllanicë jemi të rrethuar me gurthyes pothuajse 4 gurthyes veprojnë tek ne. Drejtori i Inspektoriatit që e ka lëshuar pëlqimin për këtë gurthyes është dashur të jetë i pranishëm sot dhe ta tërheq atë vendim keqbërës për qytetarët. Sa i përket këtij shqetësimi të të gjithëve sot patjetër është dashur të jenë të pranishëm edhe asambleistët tjerë këtu.

Arbëreshë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë e sidomos për qytetarët e Bellanicës që janë të pranishëm këtu! Kryesues, ne jemi dakorduar të të thirrjmë vazhdimin e mbledhjes për sot e në fokus të veçantë për gurthyesit e të japim rekomandimet tona. Këtu po shihet një joseriozitet i asambleistëve të opozitës që po e dëshmojnë edhe me mospraninë e tyre këtu.

Të nderuar qytetarë të Bellanicës ne jemi së bashku me juve dhe do ta zgjidhim këtë situatë me zgjuarsiri dhe pa politikë. Ju kërkoj falje juve që atë ditë për 3 min është mbyll mbledhja dhe u shty për një afat të pacaktuar. Ne ishim në oborrin e komunës por ska prit Kryesuesi për 2-3 min dhe sot kemi pritur më shumë se gjysmë ore që të filloj mbledhja!

Kryesues përveç neve që jemi këtu është dashur që të insistohet që të ketë të pranishëm edhe nga PDK-ja. Ata shpesh japin vërjetje për këtë e sot që e ka kërkuar nevoja veç PDK-ja nuk janë këtu.

Rrahim Morina: Arbëreshë, kërkoj më shumë sinqeritet nga ju dhe të lutem mos e provoko Kuvendin!

Arbëreshë Krasniqi: Kryesues, pse nuk është PDK-ja këtu? Pse nuk i ke asambleistët e partisë tënde këtu?

Rrahim Morina: Atëherë në mungesë të kourrumit mbledhja shtyhet për një ditë tjetër. Do t'ju informojmë me kohë.

Vazhdimi i mbledhjes përfundoi në ora 10: 55.

*

*

*

Vazhdimi i mbledhjes së XII (dymbëdhjetë) të rregulltë të Kuvendit të Komunës

Mbledhja mbahet me datë 06.01.2010 dhe filloi në ora 10:35 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 20 asambleistë, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, dhe media.

Rrahim Morina: Pershendetje për të gjithë të pranishmit! Korrum kemi dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen. Propozoj që pika e 1-rë të jetë procesverbali, e 2-ta të jetë për gurëthyesit, e 3-ta të jetë për rekomandimet nga mbledhja e jashtëzakonshme dhe e 4-ërta të jetë që të futet Plani i Punës së Kuvendit e pikat tjera të bartën më poshtë sipas radhës.

Avdi Morina: Pershendetje për të gjithë! Kryesues, ne u dakorduam për mbledhjen dhe për rendin e ditës që të diskutohet por jo edhe për rekomandimet që ju i përmendet pak më parë. Personalisht unë nuk do të jem pjesë e kësaj seance për shkak të kësaj sepse ne u morëm vesh se për çfarë do të diskutojmë. (lëshon mbledhjen)

Rrahim Morina: Atëherë a shkojmë në votim të asaj që propozova pak më lart. Kush është për që pika e 1-rë të jetë procesverbali, e 2-ta të jetë për gurëthyesit, e 3-ta të jetë për rekomandimet nga mbledhja e jashtëzakonshme dhe e 4-ërta të jetë që të futet Plani i Punës së Kuvendit e pikat tjera të bartën më poshtë sipas radhës?

Për: 13

Kundër: 0

Abstenim: 7

Me këtë votim aprovohet edhe rendi i ditës me ndryshime dhe plotësime.

Kalojmë në pikën e 1-rë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbledhjes së -II- të jashtëzakonshme të datës:27.09.2019 -II- urgjente datë:27.11.2019. E hapi debatin për këtë pikë?

Mbasi s'ka diskutues kush është pro miratimit të procesverbaleve?

Për: unanimitet (20)

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Gurthyesit në fshatin Turjakë dhe Bellanicë. Pra u morëm vesh që kjo të jetë një pikë e përbashkët. E dapi debatin.

Behije Sertolli: Pershendetje për të gjithë! Ka më shumë se 2 muaj që në fshat thuhet që do të ndërtohet një gurthyes në vendin e quajtur "Gajrak", në fshatin Bellanicë. Për të ndaluar këtë dukuri menjëherë kanë reaguar qytetarët e fshatit përmes Kryesisë së fshatit që takohen me Kryetarin e Komunës z. Begaj për këtë çështje. Kryetari ju thot atyre që po dëgjon për herë të parë që po hapet në gurthyes në fshatin Bellanicë. Sipas kësaj po del që ai nuk ka qenë i njoftuar. Ai gjithashtu ka thënë që ua jep fjalën që pa pëlqimin e fshatit kurrë nuk do të lejojë që të ndërtohet një gurthyes e që është në kundërshtim me banorët e fshatit. Pas 2 ditësh Kryesia e fshatit u është

drejtuar me shkrim me anë të një kërkesë për këtë çështje Kryetarit të Komunës dhe Asamblesë Komunale.

Pavarësisht premtimit të Kryetarit Begaj pas një muaji filluan punimet për këtë gurthyes. Thuhet që ky gurthyes është më i madh krahasuar me gurthyesit e tjerë në komunën tonë dhe njëherit më i madhi në rajon. Kjo është shqetësuese dhe e dëmshme jo vetëm për banorët e Bellanicës por për të gjithë qyteatrët e Mlishevës. Këtë nuk duhet lejuar. Për këtë janë revoltuar banorët e fshatit dhe mbajtën një mbledhje ku është bërë një peticion që u është drejtuar juve kolegë asambleistë. Pra kërkojmë sot në këtë mbledhje të merret një vendim për tërheqjen e këtij pëlqimi që është lëshuar nga komuna.

Pse të lejojmë që hapësirat tona të shndërrohen në gjërmadha, ajëri të ndotet, prandaj duhet t'u themi jo njëherë e përgjithëmonë sepse këta gurthyes nuk e plotësojnë asnjë kriter dhe janë shumë afër shtëpive.

Astrit Sertolli: Pershendetje për të gjithë! Behija i përmendi të paknaqësitë dhe veprimtaritë e banorëve të Bellanicës lidhur me gurthyesit dhe të gjitha procedurat e ndjekura për ta kundërshtuar këtë dukuri të dëmshme. Kërkesë e jona e vetmja është që ai pëlqimi i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit që të pezullohet dhe kërkoj nga ju kolegë asambleistë që ta përkrahni kërkesën tonë.

Rrahim Morina: Po flas në cilësinë e asambleistit. Çështja e gurthyesvë është bërë një temë e diskutueshme çdo ditë që po shkakton dëme të mëdha si në ambient ashtu edhe në shëndetin e njeriut. Hapi parë për të hapur një gurthyes duhet që të merret pëlqimi nga komuna, prandaj kam thënë për këta gurthyes është ekzekutivi. Pra, mos bëni politikë ja po rri ja nuk po në mbledhje sepse na si Kuvend i kemi nxjerr disa rekomandime që të zbatohen për të gjithë gurthyesit në K. e Mlishevës e ku Kryetari pas 3 muajve ka qenë i obliguar që t'i tërheq të gjitha pëlqimet. Kjo leje që nuk ka ndodh por ka lëshuar edhe pëlqime tjera e disa ishin parandaluar. Ne sot vetëm për pasojat po flasim kur kjo ka mund të parandalohet. Kjo situatë është shumë alarmante sepse nga të gjitha anët jemi të rrethuar me gurthyes. Rruga e vetme është vetëm organizimi i protestave nga qytetarët për t'i parandaluar këta gurthyes.

Alban Krasniqi: Po flasim për një dukuri kur duhet të pozicionohemi ne si asambleistë në mes të interesave të qytetarëve apo interesave bizneso-politike. Pra jemi para një situatë kur duhet të pozicionohemi në mes të interesit të shëndetit të qyteatrëve apo ndotjes së mjedisit dhe sa jemi të qëndrueshëm para santazhve, presioneve që na vijnë ndonjëherë edhe nga mafia e biznesit. Që 20 vite pas luftës po zhvillohen politika të gabuara dhe si pasojë e këtyre politikave të gabura janë edhe këta gurthyes.

Sot më erdh mirë që asambleistët e Bllanicës pavarësisht subjektit politik dolën dhe e ngritën zërin kundër kësaj dukurie, por mos prisni deri sa të ndodh tek dera juaj e ta ngritni zërin, por bëjeni me kohë sepse të gjithë jemi qytetarë të këtij vendi.

Udhëzimet administrative ndërrojnë, ndërsa Ligji për Vetëqeverisje Lokale mbetet e na thotë hapur që: nëse rrezikohet mjedisi dhe jeta dhe siguria e qytetarëve atëherë ne jemi përgjegjës për t'ju kundërvënë dhe për të marrë vendime. Normalisht përgjegjësi i mbetet edhe niveli qendror aq sa për t'i rregulluar disa procedura. As një pëlqim nga niveli lokal nuk është dhënë bazuar në procedurat ligjore që kërkohet për gurthyes. Ato thirren në procedura, disa plane por që në vetëvete kanë shkelje të mëdha të procedurave ligjore.

Ne para nesh e kemi peticionin e fshatit Bellanicë të nënshkruar nga kryefamiljarët e që në mënyrë të qartë kanë kërkuar që ky gurthyes është i papranueshëm i cili ua dëmton shëndetin, u dëmton

arat e punueshme dhe prodhimet dhe e degradon mjedisin. Këto janë argumente të forta që neve duhet t'na shtyjnë që të marrim vendim për parandalim, jo veç rekomandime që po hasin në vesh të shurdhur. Përgjegjës kryesor për krejtë këtë çështje është Kryetari Begaj me drejtorët e tij.

Një ndër kriteret për marrjen e licenës për gurthyes është që të mbahen dëgjimet publike. A e dini që asnjë dëgjim publik nuk është bërë në hapësirat publike?! Në asnjë dëgjim publik qëllimshëm nuk e ka involvuar vetën komuna në informimin e qytetarëve edhe pse janë dashur që të bëhen në bashkëpunim me komunën. Ato dëgjime publike janë mbajtur nëpër restorante dhe pa pjesëmarrës dhe ta informuar qytetarët.

Njëjtë është vepruar edhe me gurthyesin në mes të fshatit Turjakë dhe Panorc sepse Drejtoria e Urbanizimit ja ka lëshuar pëlqimin nga ish-drejtori Ahmet Morina. Ky pëlqim është dhënë pikërisht për vendin që është në formë rrethi e që besohet që është zonë arkeologjike. Pak metra nga aty është një bazen dhe as 500m larg janë shtëpitë e fshatit Panorc, pra nuk është i plotësuar asnjë kriter.

Po i lexoj disa nga propozimet për marrjen e një vendimi për të gjithë gurthyesit nga një konkluzë e përbashkët me asamblistët e Nisma dhe të LDK-së. Është dashur që sot që Nënkryetari të sjellë një vendim për tërheqjen e pëlqimit për gurthyesin e Bellanicës por ai këtë nuk e ka bërë dhe fare nuk ka ardh sot në mbledhje. Këto pika bazohen në nenin e 35-të të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në nenin e 12-të dh të 17-të po të këtij ligji.

1. Të revokohen të gjitha vendimet e lëshuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizimit për dhënien e pëlqimeve për operimin e gurthyesëve në territorin e K.së Malishevës
- 1.1 Kryetari i Komunës në koordinim me autoritetet përgjegjëse të nivelit lokal dhe qendror të përkujdesen që brenda 6-mujve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi që hapësirat e degradura nga veprimtaria e kompanive të rivitalizohen ashtu siç parashihen me legjislacionin dhe aktet tjera nënligjore përkatëse
2. Kuvendi Komunal caktohet si organi i vetëm që ka kompetencë për dhënien e pëlqimeve për operimin e gurthyesve
- 2.1 Kryetari i Komunës së Malishevës obligohet që të gjitha kërkesat e kompanive për marrjen e pëlqimit t'i dërgojë në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe miratim në formë të rekomandimit i cili duhet të përmbajë dokumentacionin përkatës nga kompania si dhe arsyetimin nga Kryetari i Komunës për përfitimin ekonomik dhe social që ka komuna dhe publiku nga një veprimtari e tillë
3. Para marrjes së vendimit nga Kuvendi Komunal, kërkesat e tilla i nënshtrohen dëgjimeve publike në të cilat ftohen të gjitha palët e prekura, banorët e fshatrave, grupet e interesit duke përfshirë anëtarët e Kuvendit Komunal
- 3.1 Njoftimi për dëgjimet publike duhet të vendoset në çeb-faqen e komunës, në hyrjet e shkollave dhe objekteve të tjera publike dhe në mediat lokale. Vendi dhe koha e mbajtjes së dëgjimeve publike caktohet nga KPF-ja në koordinim me Zyrën e Kryetarit si dhe ma palët tjera që parashihen me ligj

Për fund kërkoj që përtej të interesave, presioneve politike sepse sot është momenti të dalim në përkrahje të interesit qytetar të përgjithshëm.

Arbëreshë Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Nëse flasim për parime është mirë që të fillojmë nga vetja, nga njerëzit tanë, nga rrethi i afërt e të shpëndajmë përgjegjësitë e parimeve e jo të mbajmë biseda për parime.

Secili prej nesh po flas për K. e Malishevës jemi në gjendje të dimë për secilën familje kush dhe çka është. Kush dhe çka ka bërë dhe cilat janë burimet e të ardhurave. Po e them këtë që të vie në përfundim që asnjëri prej nesh nuk ka nevojë që të shantazhohet, të paragjykohet e as të thirremi

secili jemi më i mirë. Ne kemi nevojë që këtë ta dëshmojmë me punë dhe përkushtim për vendin tonë.

Ne grupi ynë kemi qenë të pranishëm në 2 seancat e kaluara për këtë mbledhje dhe jemi dakorduar me Kryesuesin që kjo mbledhje të thirret në vazhdim edhe për sot. Ne ju kemi përgjigjur dhe jemi këtu për ta dhënë kontributin tonë.

Në K. e Malishevës në një kohë që të gjithë e dimë është lëshuar pëlqimi për operimin e gurthyesit në fshatin Astrazub. Secili prej nesh e di që pronar i atij gurthyesi është vëllau i Presidentit Hashim Thaçi i cili përfiton miliona nga toka e Malishevës duke na shantazhur, pluhërosur e gjithë të zezat tjera.

Ne jemi dakorduar që të bëhemi bashkë për çfarëdo hapi që marrim, qoftë nevoja të shkojmë edhe tek punimet e ta parandalojmë këtë dukuri. Nëse ai nga Buroja po bëka që të vie e të shfrytëzojë gurin tonë e marrë milona, e pse nuk po bëjka për të tjerët?! Po krijojmë standarde të dyfishta. O po i ndalim të gjitha, o s'po e ndalim asnjë. Për mua jeta e qytetarit të Bellanicës është po aq e rëndësishme sa jeta e qytetarit të Astrazubit, panorcit etj.

Të bëhemi të gjithë bashkë e ti ndalim së operuari të gjitha bizneset si gurthyes në K. e Malishevës e t'ja nisim nga vëllui i Hashim Thaçit.

I nderuari Kryesues, ju antëtarë të Asamblesë, natyra biznesore gurthyesë në Kosovë gjithandej por Drejtoria e Inspektoriatit ka dalur në terren dhe ka inspektuar punimet e gurthyesit në Bellanicë të kompanisë "Ylli Mineral", me pronar Naim Cakiqin dhe kanë kërkuar dokumentacionin e nevojshëm të kësaj veprimtarie. Dokumentet kanë qenë sipas raportit të Inspektoriatit: Pëlqimi nga Drejtoria e Urbanizmit të K. së Malishevës me të gjitha detajet, vendimin e Pëlqimit mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me nr. e detaje, si dhe kërkesën për paisjen për licencë na Komisioni Pavarur për Pyje, Miniera dhe Minerale. Kompania në fjalë ishte duke i vendosur mjetet për fillimet e punës, por ne e kemi sygjeruar se pa u paisur me licencë mos të fillojë me operimin e veprimtarisë sepse në të kundërtën do të merren masat e parapara me ligj. Ky është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Drejtoria e Inspektoriatit.

Qytetarët e Bellanicës i kam takuar në dy seancat e kaluar dhe e kemi diskutuar këtë çështje dhe sot në zyrë të Kryetarit. Mësuesja Rajmondë mëso me dëgjju se sa drejtori e mësuesi me dokumenta false silltet këndej ne se ke idenë.

Problemi kryesor i gurthyesit të Bellanicës është që kompania në fjalë nuk ka mbajtur dëgjim publik dhe për këtë qytetarët e Bellanicës nuk kanë qenë të informuar. A ka ndodhur edhe për raste tjera kjo? Po ka ndodhur edhe për disa biznese tjera. Këtë e kundërshtoj këtë dhe jam krah me qytetarët e Bellanicës. Por ai gurthyes kishte punuar edhe më heret aty, ndoshta ky ka qenë vazhdimi i licencës. Ky gurthyes tokën e bal nga qytetarët e Bellanicës dhe ata është dashur me ditë që gurishta për çka blehet. Të gjithë ata që e kanë shit tokën e kanë ditur saktë se çka do të bëhet aty. Këto informacione i kam marrë nga takimet me qytetarët. Fola për raste individuale.

Ne si grup e kemi diskutuar këtë çështje dhe jemi munduar që t'i bëjmë presion Kryetarit Begaj që të sjellë një përfundim të përgjithshëm pozitiv për K. e Malishevës e të shkojmë me rekomandime për të gjitha bizneset që operojnë si gurthyes që t'i pezullojmë e më tutje të shohim se çka është më e drejtë të bëjmë. Jam skeptike që nëse ne sot votojmë jo për rekomandime por për vendim mund të jemi në kundërshtim me MAPL-në. Pra është mirë që të votojmë rekomandime e jo vendim.

Arlind Morina: Pershendetje për të gjithë! Kryesues, së pari në këto kushte nuk duhet të mbahet mbledhja sepse është tepër ftohtë. E dyta, shpresoj që ky vit të mos të jetë i gurthyesve sepse çdo vjet është hap ndonjë gurthyes, por të merremi me probleme tjera. Ne Astrazubi jemi mësuar me

këta gurthyes por kam një pyetje për Kryetarin. Kryetar, a është me rëndësi jeta e qytetarëve apo përfitimi i disa bizneseve?

Arbëreshë, gurthyesin në Astrazub e kanë prurë të gjithë ata që e kanë votuar PDK-në në atë kohë. Të gjithë bashkë kanë qenë në atë kohë.

Rrahim Morina: Shkojmë në pushimin e drekës, shihemi në ora 13:00.

Vazhdojmë me debatin pas pushimit të drekës.

Halil Morina: Pershendetje për të gjithë! Kushtet për mbajtjen e kësaj mbledhje nuk janë të favorshme sepse është shumë ftohtë.

Gurthyesit janë shndërruar në një shqetësim të madh për të gjithë qytetarët e komunës sonë të cilët së pari që kanë filluar në Astrazub e kështu me rradhë. E kuptoj shumë mirë shqetësimin e banorëve të Bellanicës dhe nuk dua që ai të shpërdoret në një Astrazub të dytë. Por, ky shqetësim i qytetarëve të Bellanicës nuk guxon që të përdoret për qëllime politike. Këtu janë 2 çështje: a duam që ta zgjidhim problemin apo duam që problemin ta përdorim për qëllime politike? Përdorimi i kësaj problematike si instrument politik është dyfish më i rëndë se sa është tani.

Së pari ne duhet të nisemi nga konteksti real dhe ligjor sepse për të operuar një gurthyes duhet të ketë licencë, atëherë komuna nuk lëshon licencë por pëlqim. Pra, pëlqimi urbanistik që i bie që në atë parcelë nuk ka të planifikuar që do të bëhet diçka. Nuk po e mbroj ekzekutivin, por nuk duhet që veç ta fajsojmë konunën sepse çështja kyçe nuk është te ne por te organet më të larta se këtu. Pra, gishti duhet të drejtohet nga Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor sepse nga jao jepet licenca e cila po i shkel kriteret.

Ne këtë problematikë mund ta zgjidhimin duke i bërë presion Ministrisë së Ambientit, konkretisht departamentit që e ka lëshuar këtë licencë. Ne duhet t'i nxjerrim disa rekomandime e t'i drejtojmë për Ministri me anë të ekzekutivit që të pezullohen të gjitha operimet e gurthyesve deri sa t'i plotësojnë të gjitha kriteret.

Për mua nuk ka rëndësi pronari, për mua ka rëndësi dhe tepër shpërndarëse është fenomeni sepse këta gurthyes me të vërtetë përveç ndotjes së ambientit po rrezikojnë edhe jetët tona. Jam kundër këtij fenomeni dhe këtë qëndrim e mbaj pavarësisht kush është pronari.

Alban Mazreku: Shqetësimin për gurthyesin në Bellanicë së pari e ka diskutuar këtu Behija dhe Nënkryetari pati thënë që Kryetari nuk e ka mendjen që të lëshoj pëlqim për këtë gurthyes. Këtu kanë gënjyer publikisht sepse pëlqimi ishte lëshuar në muajin korrik.

Kryesues kam një vërejtje edhe për ju sepse për këtë mbledhje që është planifikuar të mbahet me 30.12.2019 ne të patëm lajmruar që nuk do të vijmë.

Arbëreshë, ne grupi ynë që po na kritikon që s'jemi në mbledhje të them që ne nuk jemi të interesuar që në situata të tilla të marrim pjesë e të marrim poena politike. Ne nuk duam që ta keqpërdorim këtë foltore për interesa të ngushta të disa individëve.

Kryesues ne e diskutuam edhe para mbledhjes që a kemi të drejtë të marrim vendim, apo rekomandime duhet. Vendimi mund të kthehet nga MAPL-ja si i pabazuar në ligj. Kërkoj mendimin e Muharremit që a të marrim vendim apo rekomandime. Është mirë që mos të përdorim këtu emra të përveçëm, nëse merret një vendim le të merret për të gjithë gurthyesit.

Alban Krasniqi: Kryesues, po ju rikujtoj. Ne këtu kemi nxjerr rekomandime për këtë çështje. Rekomandimet nuk e kanë fuqinë e obligimit dhe kjo problematikë është më shumë se sa një shprehje e vullnetit. Në këtë rast edhe me ligj përgjegjës është komuna. Ju përmenda edhe më heret

ligjet. Prandaj, bazuar në ligje thash dhe mendoj që duhet që sot të nxjerrim vendim për pezullim deri sa të shihen a i plotësojnë apo jo kriteret sepse nëse sot nxjerrim rekomandime ne sot dorëzohemi para kësaj problematike dhe po ju nënshtrohemi gurthyesëve. Kërkoj që pas përfundimit të debatit e bashkarisht që ta harmonizojmë përmbajtjen e këtij vendimi dhe si e ku ta adresojmë si dhe kohëzgjatjen e tij. 7

Sylë Dukolli: Pershendetje për të gjithë! Kjo dukuri nuk është e re për ne, ka atë kohë që është shetësuese për të gjithë qytetarët e Malishevës. Ne fshati ynë kemi pas një rast të tillë dhe pavarësisht përpjekjeve të bëra si fshat nuk kemi mund që ta ndalim këtë veprimtari sepse Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor ja ka lëjuar puçnn.

I kuptoj qytetarët dhe asambleistët e Bellanicës por tani me këto peticione më s'po mund të kryejmë punë sepse ai gurthyes ka sa e sa vite që operon aty e qytetarët deri në këtë moment kanë heshtur. Tash me sa e kuptova është ndërruar pronai, e tani po i pengon. Jam që të merren masat e duhura dhe pa i plotësuar kriteret e kërkuara të mos operoj asnjë gurthyes sepse ky është shqetësim edhe për mua.

Nëse ne si Kuvend Komunal kishim dhënë pëlqime, ne mund t'i anulojmë pëlqimet tona, por në këtë rast nuk e di se sa kemi të drejtë që të marrim një vendim për pezullimin e punës së këtyre gurthyesëve? Mendoj që çka do që votohet sot le të jetë për të gjithë gurthyesit që operojnë në K. e Malishevës.

Jam kundër përmendjes së emrave këtu, neva nuk na interson pronari por veprimtaria e kompanisë, a vepron ligjshëm dhe a i plotëson të gjitha kriteret kjo na intereson neve dhe t'i përkrahim shqetësimet e qytetarëve.

Rrahim Morina: U knosultova me Muharreim dhe sipas tij ne mund të nxjerrim një vendim për pezullimin e pëlqimve të Kryetarit dhe të drejtorit të Urbanizmit që ata kanë lëshuar për të gjithë gurthyesit jo për një. Nëse pajtoheni ne mund të marrim një pauzë të shkurtër që t'i harmonizojmë qëndrimet tona në një vendim të përbashkët.

Demir Bajraj: Sot drejtori i Urbanizmit Islami është dashur të jetë këtu dhe t'i sqaroj të gjitha kriteret për një gurthyes dhe sa dëmtohen qytetarët. Këtu nuk ka kush që t'na jep ndonjë arsyeshmëri rreth këtyre çështjeve dhe pëlqimeve që po diskutojmë sot.

Sylë, peticioni është njëra ndër mënyrat më të mira për të adresuar shqetësimet tona për në Asamble e në institucione tjera. Një tërësi edhe ne kemi problem me gurthyesin në Panorë e që është afër shtëpive. Ne këtu jemi ardhur nga vota e qytetarëve dhe është mirë që t'i mbrojmë interesat e tyre pa dallime politike dhe të marrim vendim për të gjithë jo veç për një. Asnjë nga këta gurthyes s'ka mbajtur dëgjime publike prandaj edhe kemi qenë të informuar me kohë për këta gurthyes që para se të fillonin punën që të bënim diçka.

Halil Morina: Ne kemi ardhur para një situatë që a të marrim vendim apo rekomandime. Nëse vendimi është i ligjshëm sigurisht që do ta përkrahja plotësisht. Mirëpo, nëse ne sot marrim vendim epilogu i tij dihet që na kthen MAPL-ja. Në qoftëse ne marrim sot rekomandime të paktën ne mund t'i dokumentojmë kërkesat tona në fuqi e ta obligojmë ekzekutivin që të del në terren e t'i pezulloj ato pëlqime për ata gurthyes që nuk i plotësojnë kriteret.

Muharrem Morina: Kryesues ju më pyetet se a kemi të drejtë që t'ja ndërprejmë veprimtarinë? Ju thashë që: veprimtarinë ju kanë lejuar institucionet qendrore dhe ata e ndalin, jo Kuvendi.

Ndërsa ju si Kuvend mund t'i pezulloni apo revokoni dokumentet që i ka dhënë Kuvendi e ekzekutivi.

Luan Kryeziu: Pershendetje për të gjithë! Sa i përket marrjes së vendimit për gurthyes them që ne jemi organ legjislativ me fuqi në nivelin komunal e jo më lart. Ligjet i nxjerr Parlamenti dhe ne nuk guxojmë që t'i kundërshtojmë. Ne duhet që t'i harmonizojmë qëndrimet tona karshi këtyre ligjeve që ndërlidhen me veprimtarinë e gurthyesëve siç janë: Ligji nr.03/L163 për Miniera dhe Minerale, Ligji 04/L174 për Planifikim Hapësiror dhe Ligji 03/L233 për Mbrojtjen e Natyrës. Pra, komuna karshi këtyre ligjeve ta ushtroj ndikimin e vet përmes drejtorive përkatëse. Është mirë që ne mos ta shëndërrojmë komunën tonë siç është Prishtina, Fushë-Kosova, Obiliqi etj, më 0 ajër të pastër dhe ta shkatërrojmë ambientin tonë me pluhur dhe zhurma siç është ajo e veprimtarisë së gurthyesëve.

Është mirë që ne ta formojmë një komision për të ardhmen me një ekip profesionistësh e që i harmonizojnë aktet ligjore dhe nënligjore për pëlqimet apo vendimet që do lëshohen për gurthyesit. Nëse sot merret ndonjë vendim për këtë çështje ai duhet të vlejë për të gjithë gurthyesit e jo për një.

Rrahim Morina: I dëgjova propozimet e juaja si rekomandime dhe po ju lexoj edhe njëherë të bazohen në nenin e 35-të të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në nenin e 12-të dhe të 17-të po të këtij ligji.

1. Të pezullohen të gjitha vendimet e lëshuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit për dhënien e pëlqimeve për operimin e gurthyesëve në territorin e K.së Malishevës

1.1 Kryetari i Komunës në koordinim me autoritetet përgjegjëse të nivelit lokal dhe qendror të përkujdesen që brenda 6-mujve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi që hapësirat e degradura nga veprimtaria e kompanive të rivitalizohen ashtu siç parashihen me legjislacionin dhe aktet tjera nënligjore përkatëse

2. Kuvendi Komunal caktohet si organi i vetëm që ka kompetencë për dhënien e pëlqimeve për operimin e gurthyesve

2.1 Kryetari i Komunës së Malishevës obligohet që të gjitha kërkesat e kompanive për marrjen e pëlqimit t'i dërgojë në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe miratim në formë të rekomandimit i cili duhet të përmbajë dokumentacionin përkatës nga kompania si dhe arsyetimin nga Kryetari i Komunës për përfitimin ekonomik dhe social që ka komuna dhe publiku nga një veprimtari e tillë

3. Para marrjes së vendimit nga Kuvendi Komunal, kërkesat e tilla i nënshtrohen dëgjimeve publike në të cilat ftohen të gjitha palët e prekura, banorët e fshatrave, grupet e interesit duke përfshirë anëtarët e Kuvendit Komunal

3.1 Njoftimi për dëgjimet publike duhet të vendoset në ëeb-faqen e komunës, në hyrjet e shkollave dhe objekteve të tjera publike dhe në mediat lokale. Vendi dhe koha e mbajtjes së dëgjimeve publike caktohet nga KPF-ja në koordinim me Zyrën e Kryetarit si dhe me palët tjera që parashihen me ligj.

Këto i dorëzoj Alban Krasniqi por këto shkojnë në emër të Kuvendit.

Atëherë po kërkon pak pauzë për t'i diskutuar këto rekomandime për vendim. Mirë, i thrras shefat e grupeve që të shkojmë për konsultim.

Ne mbajmë një konsultë të shkurtër dhe ju them se çdo vendim shkon në MAPL për ligjshmëri nëse është pa bazë e kthen prap, prandaj personalisht mendoj që sot është mirë që të votojmë një votim. Pikat janë ato që i lexova më heret.

Arbëreshë Krasniqi: Kryesues, Avdiu ishte në takim me ju dhe mendoj që të gjithë këto pika që i lexuat ju për vendim mendoj që janë të rregullura me ligj si kritere që duhen të plotësohen patjetër. Mos të krijojmë standarde të dyfishta. Ne votojmë veç pikën e 1, jo të tjerat.

Rrahim Morina: NISMA ka një propozim pak më ndryshe. Njëherë po e hedhi në votim ato kriteret tjera në tërësi sepse u propozuan dhe u harmonizuan të parat. Kush është pro atyre pikave që i lexova më herët në tërësi?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 9

Me këtë votim aprovohen ato rekomandime nga Kuvendi Komunal në Malishevë për të gjithë qurthyesit që operojnë në këtë komunë.

Kalojmë në pikën e 3-të rendit të ditës: Rekomandimet nga mbledhja e jashtëzakonshme. Po Avdi!

Avdi Morina: Kryesues, këto rekomandime nga një seancë e jashtëzakonshme e që po tentoni që t'i votoni në një seancë të rregulltë nuk është e drejtë dhe në rregull, për këtë ne si grup politik do ta lirojmë sallën. (Nisma lëshon sallën e mbledhjes në ora 14:40)

Rrahim Morina: Fjala është veç për këtë pikë apo? Mirë! Tani 15 asambleistë jemi të pranishëm dhe s'kemi kourrum. Mbase s'ka kourrum po e presim Kushttrim pak mbase tha që është duke ardh. (pas disa min)

Ftoj Alban Mazrekun që në emër të grupeve politike PDK-së, LDK-së AAK-së dhe VV-ës që t'i lexojë rekomandimet nga mbledhja ja e jashtëzakonshme.

Alban Mazreku: Ne debatin për këtë pikë e kemi përfunduar në mbledhjen e jashtëzakonshme sot u futen në rend dite veç rekomandimet që të votohen që çështjet e mëposhtme të ngritura nga anëtarët e Kuvendit Komunal në Malishevë nga mbledhja e jashtëzakonshme t'i dërgohen Departamentit për Hetime dhe Krime Ekonomike në Policinë e Kosovës.

1. Vendimi për shpalljen e zonës për interes publik në fshatin Banjë, Bellanicë dhe Senik.
2. Shpronësimi dhe këmbimi i pronës private për ndërtimin e shkollës fillore në Panore pa miratim nga Kuvendi Komunal
3. Moszbatimi i vendimit të Kuvendit Komunal për heqjen e Billboardve përrreth Sheshit të Dëshmorëve në Malishevë
4. Moszbatimi i vendimit të Kuvendit Komunal për lejimin dhe ndalim parkingut në rrugën "Ibrahim Mazreku" në Malishevë
5. Kontrata e lidhur në mes të Kryetarit Begaj dhe kompanisë "Ekoregjioni", mos heqja e deponisë ilegale të mbeturinave në lagjen "Hoti" në Malishevë
6. Ndërtimi i pa leje dhe dëmtimi në i pronën e ndërmarrjes publike komunale i Stacionit të Autobusëve i Inkubatorit të Biznesit
7. Rregullimi i shtratit të lumit "Mirusha" në fshatin Banjë nga ura në drejtim të lagjës "Samadraxha"
8. Renovimi i objektit të shkollës së vjetër në fshatin Lladroc
9. Moszbatimi i vendimit të Kuvendit Komunal për përcatimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive në fshatin Drenoc
10. Suspendimin i zyrtarëve që kanë aktakuza nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në Gjakovë dhe dorëheqja e Kryetarit të Komunës

Rrahim Morina: Pra këto janë rekomandimet që kanë dal nga mbledhja e jashtëzakonshme. Kush është pro këtyre rekomandimeve?

Për: 15

Kundër: 1

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovohen edhe këto rekomandime.

Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020. Këtë plan e kemi përgatitur me shefat e grupeve dhe me Muharremin si përfaqësues i Zyres së Kryetarit. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Ne si KPF i kemi kërkuar Kryetarit Begaj dhe drejtorive përkatëse të listuara të gjitha strategjitë, planet e veprimit për këtë vit në mënyrë që ta hartojmë në harmoni këtë plan të punës. Ata nuk kanë sjellë asnjë listë dhe nëse vijnë vijnë jashtë agjendës sonë si punë e Kuvendit.

Rrahim Morina: Për këtë çështje që përmendi Albani u ju kam drejtuar me shkrim Kryetarit, por ai nuk ka kthyer asnjë përgjigje. Mbase s'ka diskutues të tjerë e hudhi në votim. Kush është pro miratimit të Planit të Punës të Kuvendit për vitin 2020?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me këtë votim aprovohet Plani i Punës së Kuvendit.

Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Shfuqizimi i vendimit nr. 02/601 për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e odës së komunitetit në fshatin Llazicë. Kjo lëndë është në gjykatë prandaj ne duhet ta shfuqizojmë këtë vendim. Lëndën e ka dërgu një gjykatë një palë që mendon që lokacioni është pronë e tij. Kush është pro shfuqizimit të këtij vendimi?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me këtë votim shfuqizohet vendimi nr. 02/601 për ndryshim plotësimin e vendimit n3.02/518 i datës 12.09.2019.

Kalojmë në pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit nr. 02/470 datë:19.08.2019 të Komisionit për shqyrtimin e raportit të Kompanisë "Ekoregjioni", Njësia në Malishevë për vitin 2018. Ilazi ka qenë pjesë e Komisioni dhe ai mund t'na jep disa informacione.

Ilaz Krasniqi: Komisioni i dalë prej Kuvendit për Ekoregjionin ka mbajtur gjithësej 4 mbledhje dhe ka dal me disa rekomandime urgjente.

- Të sigurohet leja mjedisore ndaj Njesisë për menaxhimin e mbeturinave gjithashtu edhe grumbullimi për vendpunimin e tyre të jetë i improvizuar e jo i hapur në përputhje me standardet e mjedisit
- Të provohet që të mbulohet në tërësi territori i Malishevës për menaxhimin e mbeturinave
- Kërkohet që punëtorët të Njesisë së "Ekoregjionit" në Malishevë të paisën me certifikata shëndetësore dhe me librezë sanitare valide
- Të specifikohen kriteret e përzgjedhjes së punëtorëve
- Të verifikohen borxhet e komunës ndaj Njesisë

- Të detajohet raporti për koston rreth 100,000.00€ nga Kuvendi i Komunës për pastrimin e rrugëve në Malishevë
- Borxhet e faturuara të provohen në në çdo mënyrë që të inkasohen qoftë në amvisëri, biznes, institucione etj.
- Njësia në fjalë duhet që t'i kryej obligimet e saj ndaj njësive të tjera siç janë: PTK, KMDK dhe sigurimeve të makinave
- Të respektohet orari i marrjes së mbeturinave në qytet dhe nëpër fshatra në mënyrë që të eliminohen shpërndarja dhe kundërmimi i mbeturinave gjithëandej
- Të ndalohet rreptësisht hudhja e mbeturinave pasi ekipi e bënë pastrimin e shportave me mbeturina qoftë para lokaleve afariste apo fshatra
- Tek hotelet të bëhet marrja e mbeturinave prej orës 22:00 ose të caktohet një orar i caktuar
- Komuna të bëjë një marrëveshje shitesë me një kompani tjetër për materialet e ngurta ngase "Ekoregjioni" nuk ka kapacitet të mbulojë një gjë të tillë
- Pas marrjes së mbeturinave siç është rasti të çerdhet, shkollat, institucionet të bëhet dezinfektimi i kontinjerëve sepse janë në vende publike

Ne si Komision kemi kërkuar edhe qasjen në dokumentet e punëtorëve por kjo nuk na është ofruar sepse këto dokumente janë në Prizren aty edhe ku e kanë selinë qendrore ata.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: I ftoj kolgët nga NISMA që edhe disa ata nga ata që s'janë kthyer të kthehen në mbledhje sepse po diskutojmë çështje të rëndësishme në dobi të qytetarëve.

Ky komision e ka kryer një punë të mirë sepse e kanë analizuar at raport dhe kanë nxjerr disa rekomandime shumë domethënëse për sa i përket gjendjes në "Ekoregjion" dhe të metat se si duhet adresuar.

Një çështje të rëndësishme që kanë kërkuar ky komision është edhe siguri i punëtorëve, mbrojtja e tyre me veshje të duhur sepse ata i kanë të paplotësura kushtet e nevojshme për punë. Ne duhet që t'i aprovojmë këto rekomandime dhe duhet që t'u japim një kohë për zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe pas një kohë të kërkojmë një raport se a janë zbatuar këto rekomandime.

Sa i përket kontratave të të punësuarëve na kanë ardhur dy dokumente nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe nga "Ekoregjioni" sa i përket kontratës burimimore. Kjo kontratë me baza mujore në vlerë 17,060.22€, diku tjetër është 16,904.54€ pra ka shkelje ligjore dhe nuk dimë se cilën prej tyre janë duke e zbatuar.

Një çështje tjetër problematike është se thuhet që grumbullimi dhe largimi i mbeturinave nga stadiumi "Liman Gegaj" 889.00€ në muaj paguhet për këtë shërbim a nuk është tepër kjo a?!

Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë, dhe të maturanëve në Malishevë 1,621.00€ e ne jemi dëshmitarë të asaj se sa po mirëmbahen varrezat e ne vazhdojmë të paguajmë për këtë. Kjo është e turpshme. Pjesë e këtij shërbimi është dashtë të jenë edhe varrezat e martirëve në Dragobil.

Sa i përket deponisë ilegale të mbeturinave i bëjë thirrje Kryetarit Begaj, drejtorit të Inspektoriatit që sa më parë t'i marrin masat e duhura ligjore e që ta ndalojnë menjëherë hudhën e mbeturinave në atë deponi në lagjen "Hoti" në Malishevë sepse rrezikojnë edhe jetën e qytetarëve qoftë përmes ndotjes së ambientit, qenëve endacakë etj.

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutues të tjerë mund t'i votojmë këto rekomandime dhe në funks të shënohet që: të obligohet Kryetari Begaj që në afat prej 3 muaj ditësh të sjellë një raport në Kuvend për zbatimin e këtyre rekomandimeve të Komisionit për Ekoregjion. Kush është pro këtyre rekomandimeve?

Për: 12

Kundër: 0

Abstenim: 5

Me këtë votim aprovohen rekomandimet e Komisionit për Ekoregjionin.

Kalojmë në pikën e 7-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Urbanizëm, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2019. Drejtori nuk është këtu. Kjo pikë në mungesë të drejtorit shtyhet për mbledhjen tjetër.

Kalojmë në pikën e 8-të të rendit të ditës: Paraqitja e listës së përfituesve me farëra dhe plehra për mbjelljet vjeshtore për vitin 2019. Ne e kemi kërkuar këtë listë, por drejtori ka thënë që ne nuk kemi ndarë plehëra dhe fara. Pra në mungesë të drejtorit e shijmë edhe këtë pikë.

Kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i dhe miratimi i kërkesës nr.02/654 datë:27.11.2019 për miratimin e Planit Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2020. Zyrtari është në pushim, unë e kam informuar për këtë mbledhje por nuk ka ardhur. Atëherë edhe këtë po e shijmë edhe këtë pikë.

Kalojmë në pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Shtabit Koordinues të ndihmave për zonat e prekura nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë. Raportin e kemi. Mbase po kërkon veç miratimin, atëherë kush është pro miratimit të raportit të Shtabit Koordinues të ndihmave për zonat e prekura nga tërmeti në Shqipëri?

Për: 18 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 11-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2020. Plani e Punës e kemi, e hapi debatën për këtë pikë.

Mbase s'ka diskutues e hedhi në votim këtë pikë. Kush është pro miratimit të Planit të punës të Komitetit për Barazi Gjinore për vitin 2020?

Për: 18 (unanimisht)

Kalojmë në pikën e 12-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullore për Transparencë në Komunën e Malishevës, sipas kërkesës nr.02/691 datë:17.12.2019. Kryetar i këtij Komisioni ka qenë Nebih Bibaj dhe e ftoj që në pika të shkurtëra ta paraqes këtë rregullorë.

Nebih Bibaj: Ne si komision i kemi mbajtur 4 dëgjime publike. E kemi harmonizuar me udhëzimin administrativ 04/2018 dhe e kemi punuar këtë rregullorë dhe shpresoj që kjo të gjejë zbatim nga ekzekutivi. Për çdo vërjetje dhe sygjerim të juajin ne jemi këtu dhe do t'u përgjigjemi.

Alban Krasniqi: Kjo Rregullorë nuk ka saksione e ndaj ndonjëherë edhe nuk zbatohet, duke u nisur nga kjo them që ëeb-faqja e komunës ka pak materiale dhe është e varfër. Edhe kur dalin disa materiale ato dalin me vonësë.

Sa i përket nenit të 6-të të kësaj Rregullore mendij që është i paqartë: "Të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasjen në dokumente zyrtare duhet të bëhen publike pas konfirmimit të ligjshmërisë së tij dhe 7 dite pune pas publikimit në veb-faqe zyrtare të komunës". Kur publikohet aty më është veç publike. Psh: një vendim nëse ne e marrim sot, sa ka afat që të vendoset në veb-faqe të komunës?

Muharrem Morina: Kjo çështje është e rregulluar me ligj dhe mbrenda 15 ditësh MAPL-ja duhet t'na kthej përgjigje për ligjshmërinë e një vendimi. Momenti kur merret një vendim në Asamble mbrenda 7 ditësh sekretaria e Asamblesë duhet që ta përgatisë vendimin dhe pasi të dërgohet në MAPL, ajo brenda 15 ditësh duhet të kthej përgjigje për një vendim të caktuar a është i ligjshëm apo jo. Nëse brenda 15 ajo nuk kthen përgjigje ai automatikisht hynë në procedurën e dokumenteve zyrtare dhe është i plotëfuqishëm.

Alban Krasniqi: Pra, mbetet që t'i rregulloni teknikisht këto pjesë tjera mungon, çështja e trasmentimit të mbledhjeve, ajo që këshilltarët të flasin prej vendeve, votimi i digjitalizuar etj. Pra të shtoni edhe një pikë për mbledhjet e Kuvendit pra te neni 4 pika e 9-të që në Kuvendin Komunal votimi i secilit anëtar të publikohet në një listë të veçantë, pra të blehen pajisjet e duhura që të flasim edhe nga vendi. Ky është propozim i imi për këtë rregullore.

Muharrem Morina: Alban, pak është e kundërligjshme kjo. Në ligj thotë: secili anëtar i Asmblesë ka të drejtë të deklarohej në procesverbal për mënyrën e votimit të vet.

Alban Krasniqi: Po Komuna e Prishtinës e ka të rregulluar ashtu siç propozova unë, pse nuk është kundërligjore atje?

Nebih Bibaj: Tek neni 20, transparenca për aktivitetet e prokurimit, propozoj që të shtohet që Zyra e Informimit t'i bëjë publike të gjitha kontratat e prokurimit publik.

Halil Morina: Kur u diskutua harmonizimi i kësaj rregullore në mes udhëzimeve administrative dhe ligjeve. Në qoftë se kjo rregullore bjen në kundërshtim me ndonjë udhëzim administrativ, ne e kemi lehtë dhe e marrim një vendim për ta anuluar atë udhëzim administrativ ose edhe ligjin.

Rrahim Morina: Mbase s'ka diskutues të tjerë e hudhi në votim propozimin e Alban Krasniqit për këtë rregullore te neni 4, pika 9 që votimi të bëhet publik për të gjitha aktet e Kuvendit të Komunës me emër dhe mbiemër të anëtarëve të Kuvendit. Propozimi tjetër ishte i Nebihut që tek neni 20 i kësaj rregullore të shtohet edhe kjo: Të obligohet Zyra e Prokurimit që t'ia sjellë Zyrës për Informim të gjitha kontratat për publikim nga procedurat e prokurimit. Me këto plotësime kush është pro miratimit të Rregullores për Transparencë në Komunën e Malishevës?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me këtë votim aprovet Rregulloreja për Transparencë për Komunën e Malishevës.

Kalojmë në pikën e 13-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës nr.02/681 datë:13.12.2019 të parashtruar nga kryesuesja e Komitetit për Barazi Gjinore. E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Çështja për të cilën është adresuar kërkesa nuk është për një çështje të caktuar. Ne kemi një Këshill për Sigurinë në Bashkësi që trajton çështje të rëndësishme por neve si Kuvend nuk na informon për çështjet që trajtohen aty dhe nga Kuvendi i vetmja që merr pjesë aty është Hidajetja si Kryesuese e Komitetit për Komunitete. Në këtë Këshill trajtohet edhe dhuna në familje me raste, sepse aty merr pjesë edhe policia. Ndërsa njoftimet apo raportet që dalin nga Zyra e Informimit është se aty u mbajt një mbledhje dhe nuk ka përmbajtje.

Pra kërkoj që prej këtij Këshilli të t'na vie një raport të punës për vitin e kaluar, cilat janë dukuritë, problematikat që i kanë hasur më shumë dhe cilat janë ato rekomandime që duhet adresohen për Kuvend që ne pastaj të diskutojmë këtu apo të marrin ndonjë vendim për ndonjë çështje të caktuar.

Në bazë të kësaj kërkesë përmenden mbi 30 raste të dhunës në familje që janë raportuar në polici. Po e shohim që kohëve të fundit dhuna ka filluar që të merr një hov ku kemi pas edhe një viktimitë për shkak të një kacafytje të disa të rinjëve. Ka edhe shumë raste tjera që nuk deklarohen në polici e që janë të natyrave të tilla. Ne nuk duhet ta lëjmë veç me këtë mbledhje dhe me kaq pak vëmendje.

Rrahim Morina: Harrova t'ju përmend që ne duhet të marrim sot një vendim për të ndarë nënave lehona nga 100€ sepse vendimi ka përfunduar. Ne duhet ta vazhdojmë këtë vendim edhe për vitin 2020 sepse me datën 31.12.2019 ka përfunduar ky vendim.

Alban Krasniqi: Pra, Kryesues propozoj sëpari Këshilli duhet t'na raportoj dhe ne është mirë që këtë çështje ta diskutojmë edhe në ndonjë mbledhje tjetër si pikë të veçantë e më pas të marrim ne qoftë rekomandime apo ndonjë vendim. Gjithashtu propozoj që të vazhdohet edhe vendimi për ndarjen nga 100€ për nënat lehona e të jetë vendim i përhershëm kjo të bëhet si ndarje me buxhet si linjë e veçantë.

Filloreta Bytyqi: Pershendetje për të gjithë! Komiteti për Barazi Gjinore nuk ka të bëjë veç për barazinë gjinore për femra, por ka të bëjë për të dy palët si për femra ashtu edhe për meshkuj. Në këtë shkresë i pashë disa rekomandime si: të formohet komiteti për barazi gjinore, e në realitet ky komitet është i formuar dhe është duke funksionuar. Këtu disa çështje janë përzier me atao të Qendrës për Punë Sociale sepse janë çështje të ndjeshme dhe s'mund të lakojmë emra këtu. Është mirë se secili organ le të kujdeset për punën e vet. Këtu po kërkohet një shumë e mjeteve, por nëse duhen këto mjete atëherë ky komitet duhet t'na sjellë një plan veprime se përse nevojiten këto mjete. Jam kundër çdo dhune dhe ne si Malishevë kemi qenë shembull se si duhej të respektohet femra e mbi të gjitha t'ja fillojmë secili nga vetvetja sepse këtu në foltore kemi pasur goxha shumë ofendime prej disa meshkujve e t'ju themi stop ofendimeve ndaj femrave më së pari këtu në Kuvend!

Rrahim Morina: Albani propozoi që Këshilli për Siguri në Bashkësi që mbrenda 3 muj ditësh ai të sjellë një informacion. Atëherë unë i drejtohem Kryetarit me një shkresë që pra të sjellë një raport për dhunën në familje dhe sigurinë në K. e Malishevës. Atëherë duhet që ta votojmë për vendim për ndarjen e mjeteve për nënat lehona.

Muharrem Morina: Nëse dikush e ka kërkuar këtë vendim, ju mund ta rikonfirmoni këtë vendim dhe ta bëni pa afat. Nëse ju doni që ta votoni një çështje që është e votuar atëherë ju njëherë duhet që ta shfuqizoni atë vendim.

Rrahim Morina: Atëherë a jeni që ta rikonfirmojmë këtë vendim e të jetë pa afat për ndarjen e shumës 100€ si ndihmë për nënat lehona?

Për: 20 (uanimisht)

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1403 datë:22.11.2019 të parashtruar nga kryetari i fshatit Astrazup për dhënien në shfrytëzim të pronës shoqërore për ndërtimin e Odës (objektit) të Komunitetit të lagjes. Materialin e keni marrë me kohë dhe kjo kalu nëpër mes Drejtorisë së Urbanizmit. Kush është pro miratimit të kësaj kërkesë?

Për: 20 (uanimisht)

Duke ju falemnderuar për pjesëmarrje me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora 16:30.

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina


